



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 4/17
Prishtinë, më 27.10.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuçi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Mytaher Haskuka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza, ministër i Financave, Lulzim Rafuna- Ministria e Financave, Salvador Elmazi-Ministria e Financave, Gëzim Beslimi- Ministria e Financave, Milaim Aliu- Ministria e Financave dhe Sanije Himaj-Ministria e Financave.

Pjesëmarrës të tjerë: Bekim Haxhiu, dhe Labinotë Tahiri – deputetë.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: kryetar i komisionit, Lumir Abdixhiku.

R e n d i i d i t ë s

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017;**
3. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017

Kryetari theksoi se neni 3 i rregullon përkufizimet. A ka ndonjë koment? Konstatoi se neni 3 mbetet pa ndryshime. Neni 4, parasheh që neni 5 i ligjit bazik të ndryshohet si vijon: ndarjet buxhetore nga fondi i

Kosovës për vitin fiskal 2017, siç janë paraqitur në tabelat 3.1,3.1A,3.1.B,3.2B,4.2.4.1,4.3 të bashkangjitura këtij ligjit miratohen në bazë të këtij ligji, a ka ndonjë koment?

Naser Osmani: Unë propozojë që neni 4 të mos aprovohet tani sepse nëse aprovohet neni 4 tani në mënyrë automatike kemi aprovuar të gjitha ndryshimet që i ka bërë Qeveria. Por t'i kemi në diskutim që në fund kur të bëhet aprovimi në parim të votohet neni 4.

Kryetari – A pajtoheni të gjithë me propozimin e z. Osmani.

Konstatoi se me të gjitha votat për neni 4 mbetet i pandryshuar. Me nenin 5, në nenin 11, paragrafi 1 të ligjit bazik, emërtimit të Agjencisë Kosovare të Pronës të ndryshohet me emërtimin e Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave. Konstatoi se neni 5 mbetet si në projektligj. Neni 6, neni 15 i ligjit bazik, paragrafët 3.6.9 fshihet nga teksti i ligjit bazik. Unë mendojë se edhe ky nen duhet të shikohet ma vonë sikurse neni 4, deri sa të kemi të qartë ende pasojën e votimit. Neni 7, neni 24 fshihet nga teksti i ligjit bazik dhe ka të bëjë me heqjen e kufizimit sipas ligjit të veteranëve 0.7% të bruto produktit vendorë. Konstatoi se me 5 vota për, 1 kundër dhe 3 abstenime, neni 7 mbetet i pandryshuar. Neni 8, përcakton se ky ligj hyn në fuqi me publikimin e Gazetës Zyrtare. Konstatoi se neni 8 mbetet si në projektligj.

Jelena Botiq theksoi se sa i përket ligjit bazik të buxhetit që është i miratuar për vitin 2017, në nenin 12 është rregulluar mënyra e ndarjes së buxhetit për investime kapitale për komunitete sipas vendimit të Qeverisë. Ky program vitin e kaluar nuk është miratuar dhe për këtë nen ka ardhur deri te mosrealizimi i buxhetit në Ministrinë për Komunitete. Prandaj kjo ministria ka suficit dhe unë kërkojë që ky nen i ligjit bazik të fshihet nga ligji i buxhetit në mënyrë që ministria në periudhën e ardhshme mund të realizojë projektet e veta e planifikuara dhe të realizojë buxhetin qysh ka planifikuar vetë ministria.

Bedri Hamza theksoi që për projektet të cilat nuk janë projekte shumëvjeçare, data 31 tetor ka qenë dita e fundit kur kanë mundur me u shpallur procedurat dhe projektet kapitale. Ne kemi mundësi një pjesë të këtyre mjeteve t'i rregullojmë mbi bazën e nenit 16 të ligjit bazik të buxhetit, ndërsa për projektet të cilat janë veç për buxhetin e vitit 2017 do të thotë nëse ka fonde dhe procedurat e prokurimit pas datës 31 tetor, nuk kanë mundësi të zhvillohen sepse janë të rregulluara me ligj.

Jelena Botiq: Zoti ministër, nëse edhe në të ardhmen mbetet ky nen gjithmonë do të jetë bllokada e kësaj ministrie.

Naser Osmani theksoi se është një çështje e cila neve na ka sjellë shumë probleme dhe e kemi diskutuar, por më tepër e kemi diskutuar me interesimin e minoriteteve jo-serbe. Ne kemi kërkuar në mënyrë decitive që qeveria nga këto mjete të nxjerrë një formulë të cilat do të ndahen mjetet në mënyrë proporcionale për komunitete.

Bedri Hamza sqaroi se në draft- ligjin e vitit të ardhshëm, ne e kemi adresuar këtë çështje, që e ngriti z. Naser Osmani me shumë të drejtë. Ne do të ndajmë në ministrit e linjës, kode të caktuara, vija të caktuara dhe shuma të caktuara për komunitete tjera. Kjo do të jetë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për projektet kapitale për minoritetet. Me shumë të drejtë u ngrit si shqetësim, por edhe këtë pengesë e cila realisht e ka pamundësuar ekzekutimin e këtyre projekteve dhe kjo nuk do të figurojë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Blerim Kuçi: Duke pasur parasysh këtë rishikim me vonesë e kishim lutur ministrin dhe stafin e tij të na tregojë për çdo amendament në aspektin kohor, se a mund të implementohet apo jo?

Kryetari njoftoi se komisioni ka pranuar 3 amendamente nga deputeti i pranishëm në këtë mbledhje, Bekim Haxhiu, të cilit ia kalojë fjalën për arsyetimin e tyre.

Bekim Haxhiu: Amendamenti 1 ka të bëjë me financimin e një projekti të ndërtimit të fushës së stadiumit të futbollit, për të cilin KF Basel e ka dhuruar barin sintetik dhe i cili ka gjetur mbështetje edhe prej KFOR-it dhe FSK-së. Kërkohen të ndahen 50.000 mijë euro për këtë projekt.

Enver Hoti: Unë mendoj që të gjitha këto amendamente dhe këtë material që e kemi dhe dokumentet e ministrisë ishte dashur që të na dorëzohen në mëngjes. Këto të cilat është duke i lexuar z. Bekim Haxhiu ne nuk i kemi dhe ishte dashur që më së largu në orën 9 të vendosen nëpër kuti postare.

Kryetari sqaroi se para juve janë disa dosje që administrata i ka shpërndarë, ju lutem t'i referohemi dosjeve sepse aty janë arsyetimet e secilit amendament.

Bedri Hamza: I nderuar deputet Haxhiu nëse është projekt shumëvjeçar procedurat mund të hapen, por nuk e shoh si mundësi brenda këtij viti që procedurat të hapen dhe të mbyllen. Unë konsideroj që më së miri me marrë për obligim për buxhetin e vitit të ardhshëm dhe viteve vijuese.

Kryetari - Z. Haxhiu, a pajtoheni propozimin e ministrit që ky projekt të trajtohet me buxhetin e vitit të ardhshëm?

Bekim Haxhiu deklarojë se pajtohet me propozimin e ministrit.

Kryetari konstatoi se deputeti Bekim Haxhiu tërheq amendamentin 1.
Amendamenti 2 i deputetit Haxhiu ka të bëjë me Ministrinë e Shëndetësisë.

Bekim Haxhiu: Më vjen keq se edhe në buxhetin e vitit të kaluar propozimet që kanë qenë për mbështetje për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë të cilat janë themeluar me ligj dhe për të cilat Ministria e Shëndetësisë nuk i ka kryer obligimet të cilat i ka pas sipas ligjit sepse aty është parapa që tri vitet e para mbas miratimit të ligjit të ndahen mjetet nga licencimi për Oda. Prandaj është konstatuar që këtyre Odave t'iu jepen nga 30.000 euro për funksionimin e tyre dhe këto Oda të mbështeten deri sa të vjen rregullimi me ligj i pakove shëndetësore.

Bedri Hamza sqaroi se këto nuk janë organizata buxhetore në aspektin ligjor është problem që të bëjë pjesë në ligjin e buxhetit, dhe kjo duhet të rregullohet vetëm përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Ne mundemi që të vendosim një shumë te Ministria e Shëndetësisë. Pastaj ajo shumë të përdoret për planifikimet e veta dhe nevojat e veta që ka. Por përmes ligjit të buxhetit nuk mundemi sepse nuk është organizatë buxhetore.

Kryetari konstatoi se deputeti Bekim Haxhiu tërheq amendamentin 2.

Bekim Haxhiu: Amendamenti 3 është një kërkesë për një mbikalim në rrugën që është ndërtuar në Klinë të Epërme në Skenderaj. Për shkak të ndërtimit të rrugëve, fëmijët që shkojnë në shkollë ju ka zgjatur shkuarja në shkollë për 1 km dhe ata shumicën e kohës nuk e bëjnë 1 km, por tentojnë të kalojnë rrugën dhe ka pasur disa aksidente me fatalitet, prandaj kam kërkuar që aty të zgjidhet problemi.

Kryetari e pyeti ministrin, a mund të realizohet ky projekt gjatë këtij viti?

Bedri Hamza theksoi se po e vendosim buxhetin e vitit të ardhshëm 50.000 euro komplet për këtë projekt.

Kryetari konstatoi se deputeti Bekim Haxhiu tërheq amendamentin 3.

Kryetari njoftoi se deputeti Labinot Tahiri ka sjellë një amendament!

Labinot Tahiri: Bazuar në datën 23.07.2014 vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndarjen e fondit prej 5.5 milionë euro për sëmundjet e leukemisë, me këtë amendament që kam propozuar, kërkojë që kjo shumë të rritet dhe të ndahet një vlerë më e madhe për këtë kategori shuma që do të thosha do të ishte 10 milionë euro në vit. Kërkojë që të trajtohet seriozisht rasti i leukemisë nga ana e Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, kemi raste të shumta të cilat duhet të trajtohen nga ju me urgjencë dhe trajtimi i kësaj sëmundje është shumë i kushtueshëm për qytetarët tanë, sidomos për këtë kategori nuk kanë asnjë të punësuar në familjet e tyre. Te rastet e fëmijëve për personat që janë mbi moshën 18 vjeç ka raste kur ministria i mbulon vetëm shumën prej 30% të trajtimit, kërkojë që kjo shumë të rritet prej 30% në 40%.

Bedri Hamza theksoi se këto trajtime i bën Ministria e Shëndetësisë në kuadër të buxhetit, i kanë fondet edhe për trajtimet edhe jashtë vendet. Z. Tahiri ma vonë mbi bazën e diskutimeve si Ministri e Financave që i kemi mirëpritur dhe i kemi vlerësuar që kanë qenë shumë propozime të drejta do t'i reduktojmë disa fonde brenda draftit aktual të ligjit të rishikimit të buxhetit do t'i zhvendosim do t'i kthejmë në pozicionet fillestare dhe pastaj përmes vendimeve të Qeverisë një pjesë e madhe e tyre do t'i çojmë në shëndetësi për adresimin e nevojave të tyre.

Naser Osmani theksoi se unë kisha pasur dëshirë që të ndahet një fond për trajtimin e këtyre sëmundjeve për jashtë vendit që janë të domosdoshme. Ato mjete janë harxhuar moti dhe pastaj Qeveria me vendime për individë të caktuar ka intervenuar. Prandaj unë konsideroj që Ministri për këtë kategori të marrë masa sepse individët janë duke pritur për t'u shëruar.

Bedri Hamza: Po e specifikojë se njëri prej propozim-amendamenteve që ne e kemi propozuar si Ministri e Financave kemi propozuar që fondi i sigurimeve shëndetësore i cili ka qenë i propozuar që të reduktohet nga 17 milionë euro dhe po themi rreth 11 milionë euro të kthehen në pozicionin që ka qenë përmes vendimit të Qeverisë në bazë të ligjit bazik të buxhetit.

Safete Hadërgjonaj: Ne, dje, kishim raportin e auditorit dhe kemi pasur shumë diskutime rreth shfrytëzimit të këtij fondi. Ne jemi Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe mundemi me thirr shumë shpejt në raportim ministrinë përkatëse se si do t'i qaset shfrytëzimit të këtij fondi, dhe me na shpjeguar në bazë cilave rregulla, procedurash shpenzohen ato mjete. Pra, ne mund të kërkojmë informata se çka po ndodh aty dhe të shohim se sa mund të gjejmë zgjidhje në të ardhmen.

Kryetari: Në vijim kemi një amendamentin e propozuar e deputetit Mërgim Lushtaku!

Mërgim Lushtaku: Unë kam propozuar një projekt-kapital i cili është ekzekutuar ma shumë punë se sa ka pasur mjete, dhe ka nevojë për buxheti për me përfunduar. Nëse ministri deklaroi se mund t'i mbulojë në aspektin tjetër këtë projekt, atëherë unë tërhiqem.

Bedri Hamza: Besojë që ne, si ministri, do t'i marrim të gjitha kërkesat e organizatave buxhetore dhe aty ku ka teprica të mjeteve nuk do të lejojmë që ato të shkojnë deficit dhe të mbesin obligime kontraktuale dhe ligjore të papaguara dhe të barten vitin e ardhshëm.

Kryetari: Konstato se deputeti Mërgim Lushtaku, tërheq amendamentin e propozuar.

Kryetari: Në vazhdim kemi 3 amendamente të propozuara nga deputeti Avdullah Hoti. Pasi deputeti Hoti nuk është prezent më takon mua që t'i lexoj amendamentin 1. Projekti me kodin 14691 fabrika e ujërave të zeza në Pejë të kthehet siç është parashikuar me ligjin për buxhetin për vitin 2017 me shumën e parashikuar prej 380 mijë euro.

Bedri Hamza: Ky projekt është i bashkëfinancuar nga KfV-në dhe nuk mundemi projekte të këtilla të hiqen dhe ka rëndësinë dhe të gjitha kanë pasur kodin, dhe me thënë të drejtën nuk e di si është kaluar dhe është hequr ky projekt! Ne pajtohemi si Ministri e Financave që ky projekt në këtë kod me shumë të kthehet dhe pastaj ne kur t'i mbledhim të gjitha shumat që i kemi shtuar si Ministri e Financave japim propozimin se ku do të hiqen mjetet.

Kryetari - E hedh në votim amendamentin 1 të deputetit Avdullah Hoti.
Konstatoi se komisioni njëzëri përkrahu amendamentin 1 të propozuar nga deputeti Avdullah Hoti.

Kryetari: Amendamenti 2 i deputetit Avdullah Hotit ka të bëjë me Projektin me kodin 15360 ndërtimi i objektit të Fakultetit Ekonomik dhe Juridik të kthehet siç ka qenë i parashikuar me ligjin për buxhetin e vitit 2017 me shumën e parashikuar për vitin 2017 50 mijë euro për vitin 2018 1 milion euro dhe për vitin 2019 1 milion e 300 mijë euro.

Bedri Hamza: Nuk është asnjë problem nga Ministria e Financave, me rëndësi është që të ruhet kodi.

Dardan Molliqaj: Unë kam një parim në këtë çështje. Zoti Hoti nuk është këtu, por megjithatë janë shumë para për këto tri vjet dhe unë kam qenë vetë në Fakultetin Ekonomik dhe mendojë ka prioritete të tjera dhe ky problem për mua është shumë i madh. Ne e dimë që s'kemi qendra të mjekësisë familjare nëpër komunat e Kosovës dhe seriozisht unë nuk po them që nuk kemi nevojë për fakultet më të mirë, por në 30 % nuk kemi ujë të pijshëm nëpër qendrat e mjekësisë familjare në Kosovë.

Kryetari: E hedh në votim amendamentin 1 të deputetit Avdullah Hoti.
Konstatoi se Komisioni me 5 vota për 2, kundër dhe 1 abstenim, përkrah amendamentin 2 të propozuar nga deputeti Avdullah Hoti.

Kryetari: Amendamenti 3 i deputetit Hoti, parasheh që në organizatën buxhetore me kod 216 Ministrisë së Punës së Jashtme në kategoritë për mallrat dhe shërbimet nga 14 milionë euro e 203 mijë e 457 euro të ndahet vetëm shuma prej 13 milionë e 403 mijë e 547 euro. Ndërsa pjesa e mbetur prej 800 mijë eurove t'i ndahet Ministrisë së Shëndetësisë dhe atë në listën esenciale të barnave në shumën prej 500 mijë euro, ndërkaq 300 mijë për shërim jashtë vendit.

Bedri Hamza: Ne jemi pajtuar me këtë pjesën që Ministrisë së Shëndetësisë t'i ndahen shumë e më shumë para për shkak të nevojave që ka sepse ka edhe obligime të pa kryera. Por u pajtuam që të zvogëlohet fondi për pagesën e autostradës dhe pastaj autostrada të rregullohet përmes rregullimit të brendshëm të buxhetit dhe këto 11 milionë që do të kthehen në pozicionet që kanë qenë me vendim të Qeverisë do t'i shkojnë Ministrisë së Shëndetësisë. Prandaj ju kisha lutur që këtë ta bëni si një lloj rekomandimi që me na obliguar që nga ky 11 milionë euro, pjesa e madhe të shkojë për shëndetësi e cila pastaj sigurisht do të reflektojë edhe ma tepër se sa këto dy shuma.

Naser Osmani: Unë propozoj që amendamenti 3 i deputetit Hoti të tërhiqet.

Kryetari konstatoi se me autorizim të deputetit Avdullah Hotit tërheq amendamentin 3.

Kryetari: Tani kalojmë te propozim-amendamentet e Ministrisë së Financave.

Bedri Hamza sqaroi se pjesa 1 e amendamenteve ka të bëjë veç me rregullimet teknike. Prej momentit kur buxheti është proceduar në Kuvend rishikimin dhe deri më sot kanë ndodhur disa ndryshime, ku janë ndarë disa mjete për rezervat e Qeverisë dhe pastaj neve sistem na kanë paraqitur gabimet. Pra, deri te amendamenti 9 janë vetëm rregullimet në sistem.

Kryetari: Unë propozoj amendamentet e propozuara prej 1 deri 9 të gjitha të hidhen bashkë në votim sepse nuk ka caktime të shumave vetëm rregullime teknike. Konstatoi se me 7 vota për, asnjë kundër dhe vetëm 1 abstenim, Komisioni përkrahu amendamentet e propozuara nga Ministria e Financave prej amendamentit 1 deri në amendamentin 9.

Bedri Hamza: Të nderuar deputet, ne gjatë këtij viti kryesisht në muajin nëntor dhe posaçërisht në fillim të muajit dhjetor do të shohim se ku do të paraqiten në sistem parat e tjera dhe pastaj t'i kryejmë obligimet për projektin e autostradës me qëllim që vitin e ardhshëm ta fillojmë me obligime të këtij viti dhe mbi bazën e diskutimeve që ne e kemi vlerësuar shumë të drejta, fondet të cilat kanë qenë të parapara për sigurimet shëndetësore, një shumë të kthehet në pozicionin fillestar. Prandaj kërkojë që të bëhet një rekomandim i këtij komisioni për Ministrinë e Financave, që me rastin e rregullimeve të brendshme sipas ligjit të buxhetit që shuma e planifikuar prej 50 milionë eurove shtesë të autostradës R-6 të zvogëlohet në 39 milionë euro, dhe 11 milionë euro të kthehen te pjesa e sigurimeve shëndetësore dhe këto mjete të shkojnë për shëndetësi, për barnat esenciale dhe trajtime jashtë vendit.

Dardan Molliqaj: Në takimin e parë që kemi pasur që e kemi lexuar këtë projekt- buxhet na keni thënë që obligimet për autostradën janë 50 milionë euro dhe nëse nuk i paguajmë kemi me marrë dënim. Tani z. ministër je duke thënë që mundemi t'i zvogëlojmë ato fonde, a nuk ka tashti obligimi apo keni gjetur ndonjë model tjetër që nuk na jep ndonjë gjobë?

Bedri Hamza sqaroi se obligimet mund të jenë edhe më shumë se 50 milionë euro, mirëpo ne në muajin nëntor dhe dhjetor ka fundi në sistem vetë organizata buxhetore t'i lajmërohet se cilat i kanë mjetet të pashfrytëzuara dhe ne, si Ministri e Financave, mund ta shohim dhe mund ta dimë se cilat kanë mjete të pashfrytëzuara.

Kryetari: E para, e aprovojmë amendamentin 9 dhe më pas e heqim punën e autostradës dhe pastaj i kthehemi rekomandimit për aprovimin e buxhetit të mbetur për barna esenciale dhe trajtime jashtë vendit.

Safete Hadërgjonaj: Amendamentet 8 dhe 9 janë të votuara vetëm duhet t'i rekomandojmë Ministrisë së Financave.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 8 vota për, i rekomandon Ministrisë së Financave, që me rastin e transferimeve të brendshme buxhetore në pajtim me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, të bëjë transferimin e mjeteve buxhetore prej 11.000.000 euro, nga buxheti i Ministrisë së Financave, nga nën-programi "Kontigjenca e Sigurimeve Shëndetësore", kategoria e pagave dhe mëditjeve, në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, për blerjen e barnave të listës esenciale dhe për financimin e shpenzimeve për shërim jashtë vendit.

Bedri Hamza: Ne e dimë që janë krijuar edhe dy ministri të reja dhe ato duhet të kenë staf secila ministri e ka numrin e vet. Amendamenti 10 i propozuar nga Ministria e Financave është që në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në programin e administratës qendrore numri i punëtorëve prej 3 pozitave të ndryshohet në 8 pozita sepse ata duhet të kenë staf, dhe në programin zyra e Ministrisë numri i punëtorëve prej 9 pozita të ndryshohet në 13 pozita.

Kryetari konstatoi se me 7 vota, për, 2 kundër dhe 1 abstenim miratohet amendamenti 10 i propozuar nga Ministria e Financave.

Dardan Molliqaj: Çështja e invalidëve të luftës që janë shtuar a do të fillojë pagesa?

Bedri Hamza sqaroi se këtë çështje e ka mbyllur komisioni dhe janë bisedat që të hapet ai komision. Unë nuk e di saktë, por ka pretendime që një numër i invalidëve të luftës nuk ju ka njoftuar statusi i invalidit për shkak se nuk funksionon komisioni. Tashti ende nuk është formuar komisioni kur do të formohet dhe si do të funksionojë është në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Jelena Bontiq theksoi se duke pasur parasysh që buxheti i vitit të ardhshëm është ardhur shumë shpejt dhe ka ardhur një kërkesë në komision nga Ministri për Komunitete dhe është fjala për shpërndarjet të brendshme dhe ne duhet që ta bëjmë një amendament.

Bedri Hamza sqaroi se sipas nenit 16 të ligjit të buxhetit i jep autorizime Qeverisë që në tremujorin e fundvitit 5% e totalit buxhetor merret me rregullime të brendshme. Prandaj të gjitha këto që kanë mbetur nga Ministrinë kanë mundësi që t'i drejtohen Ministrisë së Financave dhe përmes Ministrisë së Financave me vendim të Qeverisë të bartë rregullimet e brendshme dhe jo të bëhet një numër i madh i amendamenteve dhe të ngarkohet edhe komisioni edhe Kuvendi.

Jelena Bonti theksoi se në fakt kërkesa ka ardhur te ju dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim faktikisht të rishpërndarja e tyre.

Bedri Hamza sqaroi se kjo ligjërisht është e lejueshme dhe kjo kategorikisht është kërkuar bartje prej një kategori në kategorinë tjetër dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që duhet të kryhet përmes nenit 16 të ligjit të buxhetit. Kërkesa duhet të bëhet në Ministrinë e Financave deri sa të kryhet rishikimi i buxhetit.

Kryetari: Tani kemi të bëjmë me 4 kërkesa. Kërkesa 1 është për Agjencinë e arsimit profesional dhe arsimit për të rritur të cilat kanë kërkuar buxhet shtesë 275 mijë euro, dhe këta kanë një problem i kanë 495 punëtorë ku në fillim të vitit ju ka ndarë një buxhet por problemi është ata nuk kanë llogaritur asnjë kontribut pensional, as përvojë të punës.

Bedri Hamza theksoi se ministrinë nuk kanë nevojë me ngarkuar me kërkesa komisionin për buxhet dhe financa, por ata kanë nevojë që të vijnë në Ministrinë e Financave dhe përmes nenit 16 të ligjit të buxhetit me iu plotësuar këto kërkesa që mund të jenë të arsyeshme.

Safete Hadërgjonaj: Zoti Ministër, ju faleminderit për sqarim po e llogarisim se e rregulloni brenda Qeverisë. Prandaj është mirë që ta merrni si obligim që vërtet ta analizoni mirë me Ministrinë e Arsimit dhe të bëni zgjidhje rreth këtij problemi pasi që vërtetë është nevojë për t'u zgjidhur ky problem.

Bedri Hamza: Unë nuk i refuzova kërkesat e ministrive, por i pranova si kërkesa të arsyeshme dhe këto kanë arsye të rregullohen brenda për brenda Qeverisë, pa e ngarkuar Komisionin për Buxhet dhe Financa me amendamente.

Kryetari: Konstato se komisioni unanimisht përkrahu propozimin e ministrisë të Financave, që kërkesa e Ministrisë së Arsimit të trajtohet me rastin e rregullimeve të brendshme sipas ligjit të buxhetit 2017.

Kryetari: Kërkesa 2 është e Kompanisë rajonale për mbeturina-pastrimi që kërkon subvencion prej një shume 1.6 milionë euro. Arsyetimi i tyre është që këta i kanë falur, sipas ligjit 2 milionë euro dhe tashti kanë vështirësi me i mbuluar kostot e tyre.

Bedri Hamza theksoi se shumica e ndërmarrjeve publike, posaçërisht këto ndërmarrje që merren me menaxhimin e mbeturinave kanë vështirësi financiare. Raste të ngjashme kemi në të gjithë Kosovën, tashti këto situata janë të vështira sepse është një shumë e madhe dhe pastaj të gjitha ndërmarrjet nëpër komuna do të vijnë të kërkojnë fonde sepse e njëjtë gjë është edhe me ndërmarrjet publike. Mirëpo unë besoj që komisioni edhe ministria e linjës dhe të gjithë ne do të jemi të kujdesshëm që këto ndërmarrje t'i bëjnë financiarisht qëndrueshme, përndryshe nëse vijnë këto edhe secila lyp subvencione prej buxhetit të shtetit ia rritë shpenzimet shtetit dhe nuk reflektojnë shpenzimet e të hyrave dhe është e papërballueshme.

Kryetari konstatoi se Komisionit me një votë Për, 7 kundër dhe 1 abstenim nuk përkrahu Kërkesën buxhetore të Kompanisë rajonale për mbeturina-pastrimi.

Kryetari: Kërkesa 3 është prej Ministrisë së Bujqësisë. Arsyetimi i tyre është se Qeveria e Kosovës me rastin e miratimit të rishikimit të buxhetit, në Ministrinë e Bujqësisë, në nën programet dhe departamenti i analizave ekonomike dhe statistikave bujqësore kod 47 300, shuma e mjete prej 212 mijë euro në kategori ekonomike subvencionet, nuk është transferuar.

Bedri Hamza theksoi se ne kemi bërë mirë që se kemi bërë transferimin e këtyre mjeteve, sepse nëse ishte bërë transferimi mua m' u kishte dashur që me lypur barazimin teknik që aplikohet në çështjet të tjera. Prandaj duhet të bëhet rishikimi dhe këta duhet që të vijnë me kërkesë në Ministrinë e Financave. Kjo është ligjërish e rregulluar brenda Qeverisë, mirëpo nuk mundesh të njëjtën kohë me pas edhe rishikimin edhe në të njëjtën kohë me ia bërë transferimet.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 1 votë Për dhe të gjithë të tjerët Kundër, nuk përkrah kërkesën buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë.

Safete Hadërgjonaj: Zoti ministër, unë e kam një propozim për rregullimin e emërimit të një projekti që është lëshuar gabimisht. Pra, është fjala për një projekt që është në Ministrinë e Infrastrukturës që është “Asfaltimi i rrugës në Rugovë-Has”. E kam parë që Ministria e Infrastrukturës ka bërë një memorandum mirëkuptimi me Komunën e Prizrenit, e që në fakt nuk është në rregull pasi që ky fshat gjendet në Gjakovë dhe jo në Prizren. Pra, te projekti në fjalë, të ndryshohet komuna nga Prizren në Gjakovë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi propozimin e deputetes Safete Hadërgjonaj dhe propozon amendamentin me tekstin si vijon:

“Në organizatën buxhetore “**Ministria e Infrastrukturës**”, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si vijon:

Nën-programi “Projektet e bashkëfinancimit me Kuvendet Komunale”, me kod 42000, në tabelën 3.2, emërtimi i Projektit „Asfaltimi i rrugës Rogovë –Has- Prizren”, me kod 15371, ndryshohet në emërtimin „Asfaltimi i rrugës Rogovë- Has - Gjakovë”.

Naser Osmani: Kam një propozim për amendamentin dhe kisha lutur që mjetet për Gjilan të rikthehen në pozicionin që kanë qenë të autostradës, sepse të gjitha procedurat janë duke përfunduar.

Bedri Hamza theksoi se nuk është problem që ato mjete të kthehen sepse është projekt shumëvjeçarë dhe do të dinamizohet puna në vitin 2018 dhe në vitin 2019 të përfundojë. Ne, si Ministri e Financave, jemi të pajtimit të kthehen mjetet në autostradën në projektin e cila ka qenë e paraparë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi propozimin e deputetit Naser Osmani dhe propozojë amendamentin me tekstin si vijon:

“Në organizatën buxhetore **“Ministria e Infrastrukturës”**, me kod organizativ 205, bëhen ndryshimet si vijon:

Në nën-programin “Ndërtimi i Autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.1, kategoria e shpenzimeve kapitale, shuma prej 180,786,415 €, ndryshohet në shumën 182,486,415€.

Nën-programi “Ndërtimi i Autostradave”, me kod 42200, në tabelën 3.2, në Projektin “Rruga Nacionale Prishtinë-Gjilan-Konçul”, me kod 15090, shuma prej 150,000 €, ndryshohet në shumën 1.850.000€.”

Blerim Kuçi: Sa i përket amendamentit 4 desha të dijë, a do të votohet sot apo ndonjë ditë tjetër sepse nuk e miratuam amendamentin 4?

Kryetari sqaroi se nuk ka nevojë që të votohet tash, neni 4 sepse bëhen ndryshime saktësisht nëpër tabela dhe e votojmë tabelën e re sipas ndryshimit.

Sipas të gjitha gjasave ne do ta mbajmë mbledhjen të hënën në orën 10 dhe do ta votojmë raportin me amendamente dhe do të procedohet më tutje për shqyrtim në komisionet e tjera të përhershme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Lumir Abdixhiku